



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

EKSTRAKTI

i procesverbalit të mbledhjes së parë të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, e mbajtur më 14.04.2022, duke filluar në orën 10:00.

Nën kryesimin e kryetarit të Komunës së Prishtinës, z. Përparim Rama, është mbajtur mbledhja e parë e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, ku u diskutuan një sërë çështjesh të cilat i preokupojnë qytetarët e komunës së Prishtinës, duke filluar nga situata e sigurisë, gjendja në shkollat e Prishtinës, trajtimi i qenve endacakë etj. Në këtë takim morën pjesë përfaqësues të Kuvendit të Komunës dhe drejtoreve të Komunës së Prishtinës, përfaqësues të këshillave lokale, përfaqësues nga Policia e Kosovës, FSK, përfaqësues të bashkësive fetare dhe qytetarë.

Në këtë mbledhje u shqyrtuan 7 pika të rendit të ditës: *Miratimi i Planit dinamik të punës dhe Planit të veprimit, vlerësim mbi çështjen e sigurisë në komunën e Prishtinës, informatë nga Policia e Kosovës, situata me zjarre pranverore - fushore dhe malore, siguria në shkolla, përdorimi i substancave narkotike dhe bartja e mijeteve tjera të rrezikshme, informatë nga shtabi emergjent mbi gjendjen e pandemisë COVID -19, situata me qen endacakë në komunë pas shpalljes së gjendjes emergjente dhe të ndryshme.*

Me të filluar takimin, kryetari i Komunës, Përparim Rama, përvendetë të pranishmit për prezencën e tyre. Ai vlerësoi lart funksionimin e këtij Këshilli. Sipas tij, është tejet e rëndësishme dhe më se e domosdoshme që të këtë një bashkëpunim sa më të mirë në mes Komunës së Prishtinës dhe KKSB-së, me qëllimin e paraqitjes së të gjitha brengave të qytetarëve. Rama potencoi se është në dijeni se në komunë e Prishtinës ka shumë probleme, të cilat vetëm me një koordinim të përbashkët mund të gjinden mënyrat më të mira për t'i zgjidhur. Ai tha se me kënaqësi po i nisim takimet tona, të cilat jam i bindur se do të ndikojnë në ngritjen dhe përmirësimin, për synimin tonë të përbashkët, pra sigurinë në bashkësi. Duke marrë parasysh gjithë gamën e përgjegjësive dhe numrin e pjesëmarrësve, takimet e KKSB-së do të jenë një platformë, ku do të ngrihen dhe do të zgjidhen në mënyrën më të mirë shumë nga brengat e qytetarëve, sidomos ato çështje që janë më rëndësi parësore për jetën e sigurt dhe të qetë të qytetarëve të kryeqytetit dhe zonave përreth. Funksioni i Këshillit Lokal për Siguri në Bashkësi njihet edhe për policim në bashkësi, që sipas Departamentit Amerikan është vlerëuar si tejet i rëndësishme për promovimin e sfidave në bashkësi dhe është mënyre e mirë për të gjetur mënyrat e zgjidhjes së këtyre problemeve. "Kjo që po bëjmë ne sot njihet dhe si policim në bashkësi, një koncept ashtu siç është përshkruar edhe nga Departamenti Amerikën i Drejtësisë, që promovojnë zhvillimin e partneriteteve strategjike, që ndihmojnë

Faqe 1 nga 1

Adresa: Rr. UÇK- 2-10,000 Prishtinë-Kosovë

Telefon: + 381(0)38/230-900

<http://888.prishtina-komuna.org>

në teknikat e përshtatshme për zgjedhjen e problemeve, si dhe trajton në mënyre proaktive faktorët që cenojnë çështjen e sigurisë, siç janë krimi, frika nga krimi, çrregullimet sociale dhe fenomene të tjera që mund të ndikojnë në jetën dhe prosperitetin e qytetarëve.

Kryetari i Komunës, z. Rama theksoi se problemi me kolektor, rruga "A", në të cilën kalon nga rruga e Veternikut dhe nga lagija "Kalabria", projekt i eshtë në përfundim e sipër, dhe së shpejti fillon dhe tenderi për përzgjedhjen e kompanisë për ndërtim. "Nesër përfundon revidimi, javën tjetër e gatshme në tender për me përzgjedhur kompaninë dhe me filluar ndërtimin. Prej rrugës "A" deri tek hoteli "Gardern", një km, në anën e lagjes "Kalabria" dhe në anën e Prishtinës së Re. Këto janë intervenime të mëhershme që do t'i vazhdojmë. Edhe projekti i ndriçimit sa kemi këputu me OSHP-në dhe me shërbimet publike, dhe kjo është duke u rregulluar.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari i Komunës, prezantoi edhe rendin e ditës, të përbërë prej 7 pikave dhe hodhi në votimin pikën e parë të rendit të ditës "Miratimi i Planit dinamik të punës dhe Planit të veprimit Vlerësim mbi çështjen e sigurisë në komunën e Prishtinës, dhe u miratua me shumicën e votave të të pranishmëve.

Me të hapur diskutimin, i pari fjalën e mori Ilmi Uka, përfaqësues i KKSB-së për fshatrat Parapashticë, Keqekollë, Dobishevë, Koliq, i cili kërkoi të diskutohet edhe për çështjet infrastrukturore në qytet. Ai u shpreh se pyetja ime konsiston me projektet infrastrukturore, por a do të diskutojmë sot apo të mbetet në pikën "Të ndryshme".

Kryetari Rama kërkoi që në takimin e parë të diskutohet vetëm çështjet e sigurisë dhe ato të rendit të ditës, ndërsa në takimet e ardhshme do të shtjellohet infrastruktura, e cila do të jetë pjesë e rendit të ditës. "Sot kërkoi që të diskutohen çështjet e sigurisë dhe ato të rendit të ditës. Në mbledhjet e radhës do të vendosim infrastrukturën në rend të ditës.

Kryetari Rama, kërkoi nga tre komandantët e stacioneve policore të raportojnë për gjendjen e sigurisë në Prishtinë.

Major Vjollcë Hoti, komandante e Stacionit Policor Jugu, në Prishtinë, tha se gjendja e sigurisë në këtë pjesë të qytetit është e qetë në përgjithësi. Aktiviteti policor është i shtuar, krahasuar me vitin paraprak, në disa vepra penale ka rënje të theksuar, siç janë vjedhjet, grabitjet, ndërsa në disa prej tyre ka ngritje, siç është dhuna në familje. "Meqenëse është takimi i parë për vitin 2022, unë kam marrë me veti reportin për vitin 2021 dhe desha ta prezantoj para jush për aktivitetet kriminale dhe veprat tjera. Vjedhje e rëndë krahasuar më vitin 2020 ka shënuar rënje, 23.6 %, rasatet e grabitjeve krahasuar me vitin 2020 ka shënuar rënje për 27.3%, vepra penale lëndim i rëndë trupor ka shënuar rënje për 21 %. Pjesëmarrja në rrahje, falë angazhimit të stafit policor, që këto ndodhin zakonisht në afersi të shkollave ose jo vetëm, ka shënuar rënje më 87,5 %, veprat penale të narkotikëve, që ishte një ndër pikat e rendit të ditës, kanë shënuar ngritje për 40% dhe janë sfidë aktualisht për Prishtinën. Veprat penale të armëve kanë shënuar ngritje për 120,3%, ngritja e zbulueshmërisë së rasteve krahasuar me vitin paraprak, në vitin 2021 ka arritur ngritje shkallën për 65.1%. Sa i përket rasteve të dhunës në familje, në vitin 2021 kemi pasur ngritje të këtyre rasteve prej 12,5%. Mirëpo krahasuar me periudhën para pandemisë dhe pandemisë, 2010 dhe 2020, kemi pasur ngritje për

Faqe 2 nga 1

58.8%. Aktualisht në kuadër të stacionit jugu janë duke u implementuar 14 plane të ndryshme operative aktive.

Majorja Hoti përmendi edhe sfidat më të cilat përballen si stacionin, siç është edhe urbanizimi i vazhdueshëm i Zonës së Jugut dhe zhurma e madhe që vazhdon të jetë një ndër shqetësimet e vazhdueshme nga banorët, si dhe mungesa e kamerave të sigurisë. Sfidat e Stacionit Jugu që ndërlidhen më Komunën e Prishtinës janë zhvillimi urbanistik i vazhdueshëm, i hovshëm i zonës së përgjegjësisë, i objekteve të banimit dhe objekteve industriale. Sfidë tjetër që po na përcjell në vitet e fundit është edhe bezdisja publike. Ne kemi shumë qytetarë të cilët banojnë kryesisht në lagjen "Mati" në lidhje me zhurmat dhe këto zhurma ndihen kryesisht para orës 10:00, kur nuk mundemi me sanksionuar sipas ligjit për rend dhe qetësi publike gjatë ditëve të javës dhe të vikendit, para orës 22:00 dhe 23:00. Sfidë tjetër për të cilën e nge çështjen është mungesa e monitorimit me kamera. Në vitin 2021, në kuadër të Stacionit Policor Jugu, është krijuar edhe Këshilli Lokal për Siguri Publike, e ashtuquajtura Lagjja e Spitalit dhe lagjja Mat, e cila mbulon prej shkollës së Mjekësisë deri në fund të Zllatarit, deri tek Badovci.

Komandanti i policisë në Zonën Jugu, Januzi tha se si objektiv strategjik kanë edhe krijimin e Këshillit Lokal, për Siguri Publike në lagjet "Ulpiana" dhe "Bregu i Diellit". Ajo kërkoi mbështetjet nga Komuna e Prishtinës, institucionet e tjera OSBE-ja, KFOR-i në mbështetjen me projekte të ndryshme për këta këshilla lokalë, me qëllimin kryesor përmirësimin e jetës së qetarëve të kësaj ane.

Ndërkaq për Gjendjen e përgjithshme të Sigurisë në zonën Qendër raportoi, **Niman Januzi, Komendant i Stacionit Policor Qendër**, i cili potencoi se gjendja e sigurisë në Qendër në përgjithësi ka qenë e mirë. Sipas tij është për t'u vlerësuar, se në këtë tremujor ka ngritur të aktivitetit policor në zbulueshmërinë e rasteve apo veprave penale-kriminale. "Sa i përket specifikave në Qendër, sa i përket mbuleshmërisë së territorit ka shumë, por ka rëndësia e institucioneve dhe problematikave që shfaqen me duket që të jemi më kryesoret në Kosovë. Për çështjet e rezultateve paraprake veç i përmendi Majorja, ashtu qëndrojmë, edhe ne merremi me staf, statistikat nuk i kamë. Kam statistika për tremujor, jemi mirë me raste dhe zbulueshmërinë. Kemi ngritur të zbulueshmërsë, kemi ngritur të personave të arrestuar dhe dërguara para institucioneve tjera, para gjykatës dhe prokurorisë, kemi mbulimin e protestave, kemi plane, mbi 40 plane të zbatuara deri në ketë ditë, ndërsa aktive mbi 10. Kemi plane ditore, javore, mujore, mos të flasim afatgjate. Edhe ne kemi të njëjtë kërkesa, e njëjta problematikë me lokale edhe natën me zhurma që krijojnë që qytetarët i shprehin shqetësimet përmes thirrjes direkte në polici. Për trafikun mbeten punime me rrugë. Çështja tjetër, hapja e pandemisë, ka frekuente shumë të madha të qytetarëve në qytete dhe tek vendosja e kamerave, do të ishte një ndihmë madhe me përkrahur këtë projekt, qofte më donacione si nga organet komunale që do të ndikojnë në zbulëshimirinë e kimeve apo ndikimin preventiv. Ndërsa bashkëpunimi me institucionet komunale shumë i mirë.

Melihate Sefedini, zv. komandante e Stacionit Policor Veriu, theksoi se në Zonën e Veriut gjendja e sigurisë është mjaftë e mirë. Kësaj gjendjeje të mirë i ka kontribuuar edhe bashkëpunimi me qytetarët dhe me komunitete që jetojnë në këtë pjesë. "Gjendja e sigurisë në këtë rajon është e qetë dhe e sigurt. Sigurisht që merita më e madhe u takon banorëve të zonës, përkatesisht komunitetit, ku shfrytëzoi rastin t'i falënderoj për bashkëpunimin e treguar me policinë e Kosovës, që ka ndikuar në gjendjen e sigurisë në Stacionin Veriu, dhe kontribut të pamohueshme kanë edhe anëtaret e KSLP-ve, ku përmes Këshillave Komunal për Siguri

Faqe 3 nga 1

kanë kontribuar për këtë siguri dhe gjendje të mirë të sigurisë. Ajo falënderoi drejtorët e shkollave, forumet rinore, udhëheqësit fetarë, komunitetet pakicë të cilat jetojnë në këtë zonë, si dhe aktorët e tjerë më të cilët kemi bashkëpunuar me pjesëtaret e FSK-së dhe KFOR-it”.

Sipas zëvendëskomandantit Sefedini, nga një analizë të tremujorit të parë të këtij viti, krahasuar me vitin paraprak, ka ngritje të veprave penale për 8%. Sipas saj, ngritje janë shënuar edhe tek përdorimi i lëndëve narkotike, numri i fletëparaqitjeve, rastet e dhunës në familje, numri i lartë i aksidenteve rrugore. Kemi bërë analizën e tremujorit, janar-mars 2022, krahasuar me periudhën paraprake, në stacionin policor veriu kemi ngritje të rasteve për 8%, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Kapitujt e veprave penale të cilat kanë shënuar rritje në këtë periudhë, kryesisht janë veprat penale kundër jetës dhe trupit, në veçanti veprat penale kundër martesës dhe familjes, që kanë shënuar një rritje prej 68% dhe veprat penale të kanosjes. Në këto dy vepra penale preventiva policore pothuajse është e pamundur. Këtu është mirë ndoshta të bëhet një hulumtim për rastet e dhunës në familje, nuk kemi arritur me vërtetur se a është si shkak i vetëdijesimit, apo se numri i dhunës në familje si dukuri është rritur. Gjithashtu, ngritje të veprave penale kanë shënuar edhe rastet e narkotikëve dhe të armëve. Këtu mund të konsiderojmë se ky është një proaktivitet i njësiteve policore që kanë rezultuar edhe me kapjen e kryerësve të këtyre veprave penale. Ulje të veprave penale kemi te kapitujt e veprave penale kundër pasurisë, që është e 20%, të këtyre veprave. Kjo është si rezultat i punës së zyrtarëve policor dhe planeve operative të cilat i kemi ne vazhdimësi, si dhe policët të cilët i kemi angazhuar edhe në rroba civile. Gjithashtu rritje të rasteve kemi tek aksidentet në trafik, që krahasuar më vitin e kaluar kemi plus 11%. Rritje kemi dhe tek numri i fletëparaqitjeve që janë shqiptuar, mirëpo këtu kemi analizuar dhe kanë ndikuar disa faktorë. Faktorët që kanë ndikuar janë punimet në rrugët “Vellezërit Fazliu”, “Ilir Konushevci”, “Bajram Bahtiri”. Ndër faktorët që kanë ndikuar në rrügen e këtyre aksidenteve janë mungesa e sinjalizimeve horizontale dhe vertikale, për të cilat disa herë kemi bërë edhe kërkesë, me shkrim iu kemi drejtuar institucioneve kompetente, po deri më tash nuk kemi përgjigje. Gjithashtu, si faktor tjetër që ndikon në aksidente janë punimet në rrugë dhe moskthimi i rrugëve në gjendjen e mëparshme. Rritja e numrit të takrive ilegale, sidomos kombibusëve në linjën 3, por edhe taksitë ilegal në relacioni Prishtinë-Podujeve.

Sefedini përmendi se si problematikë mbesin edhe parkimi vend e pavend i veturave, pasi që objektet apo lokalet afariste nuk kanë parkime, çka i detyron qytetarët të parkohen në trotuare. Sipas saj, edhe kompania “Pastrimi” parkohet në trotuar. Ndërsa ajo vuri thesin edhe tek ekspozimi i mallrave në rruge dhe kanali në Breznicë që është i hapur dhe parqet një rrezik të përhershëm për qytetarët e kësaj zone.

Hetem Kupina, përfaqësues i KKSB-së në Bardhosh, lidhur me diskutimet për çështjet e sigurisë, tha se për çdo kërke se që adresohet duhet të drejtohet në institucionet përkatëse, që janë përgjegjëse për të ndërmarrë hapat për të zgjidhur problemin. Sipas tij, takimet duhet të jenë sa më përbajtjesore dhe të ndërmerrën hapa konkretë në zgjidhjen e këtyre problemeve me të cilët përballen qytetarët në zonë të Prishtinës. Gjithmonë këtë temë e shprehu duke u bazuar në përvojën time për të dhënë kontribut edhe në mbarëvajtjen e takimeve, kush jemi ne, cilat janë detyrat e pakicave dhe këshillave, dhe çfarë roli ka Këshilli Komunal për Bashkësi, të cilat kanë për detyrë identifikimin e shkaktarëve që e cenojnë sigurinë dhe ne ku duhet t'i adresojmë. Në polici nuk duhet të raportojmë se kanë shpërthyer ujarët zeza, por janë organet kompetente. Këto gjëra duhet t'i definojmë mirë dhe të dimë mirë kush, cili, çfarë detyre ka dhe kush për çka duhet të jetë përgjegjës.

Faqe 4 nga 1

Kupina kërkoj po ashtu që çdo përfaqësues i KLSP-ja të adresohet, në mënyre që takimet të jenë sa më të suksesshme.

Ilirjanë Bunjkau, togerë, përfaqësuese e FSK-së, tha se ajo si pjesëtar e FKS-së është në gjendje të gatishmërisë për të ofruar një bashkëpunim sa më të mirë me komunën dhe qytetarët. Ajo tha se tash për tash nuk kamë një pikë me diskutuar, vetëm dua të tregoj gatishmëri për bashkëpunim lidhur me misionin tonë. Me të gjitha kapacitet jemi të gatshëm me i dal në mbështetje Komunës së Prishtinës.

Për të folur lidhur me problemet e zonës së Matit dhe Lagjes së Spitalit, zonë kjo mjaft e urbanizuar, **Mevlude Kasumi** nga KLSP e kësaj zone, tha se problematikë me të cilat përballet kjo zonë e urbanizuar e qytetit është ndotja akustike, që paraqet probleme të vazhdueshme, për të cilën ka ankesa nga qytetarët e zonës. Sipas saj, kjo çështje ka mbetur si e patrajtuar, për shkak se nuk është marrë seriozisht asnjëherë kjo çështje për t'u zgjidhur dhe çdo herë përgjegjësia ka kaluar nga një institucion në tjetrin. "Kisha pasur dëshirë me pasur një bashkëpunim më të madh në mes Policisë së Kosovës dhe Komunës së Prishtinës. Arsyja pse unë jam sot, është çështja e një problemi shumë të madh, që i përket zonës sime, të rrugës B dhe lagjes "Mati 1" e që është ndotja akustike. Ndotja akustike është një problem që e përmenden edhe dy komandantët e policisë, është një problem i Prishtinës, që shumë gjatë ka mbetur pa adresuar edhe pa u zgjidhur. Për moszgjidhjen e saj ka munguar bashkëpunimi mes policisë dhe Komunës. Është një përgjegjësi që ne qytetarët kur thërrasim polisinë, gjithmonë e adresojmë këtë problem, mirëpo policia përgjigjet se kjo është kompetencë edhe e Komunës, e që policia nuk mundet me zgjidhur vetë. Prandaj pres një bashkëpunim shumë më të ngushtë nga ekzekutivi i ri më polisinë në zgjedhjen problemeve tona të cila i kemi, sepse pa një bashkëpunim, mbeten problemet e paizoluara e kompetencat duke u shtyrë prej një organi te tjetri, prej Policisë në Komunës e kështu me radhë.

Lidhur më këtë çështje, **Përparim Rama**, kryetar, sqaroi se këtë çështje e kanë marrë me seriozitet, sidomos për zhurmën që është një problem i madh. "Ne kemi marrë këtë çështje dhe tjerat me rendësi, sigurisht kemi pasur takime të shumta dhe e kemi caktuar se do të kemi takime çdo muaj, posaçërisht zhurma, që është një problem shumë i madh.

Violeta Hyseni, **KLSP Qendër**, theksoi se është shumë e kënaqur që nga ardhja e re e kësaj qeverisje. Sipas saj, disa gjëra kanë ndryshuar për të mirë, e cila ka qenë brengë kryesore e qytetarëve të kësaj zone, ka filluar të zvogëlohet. Kjo është si rezultat i një bashkëpunimi të mirë që kanë mes Komunës, drejtorëve komunalë, Policisë dhe qytetarëve. Ndihem shumë e lumtur, 8 vjet paraprakisht nuk e kemi pasur kryetarin e Prishtinës, tani po shohim një ndryshim në qeverisje, pasi që në zonën ku jetoi zhurma nuk është askund ashtu si ka qenë më parë. Janë pjesërisht disa rrugë, rr. "Rexhep Laci" dhe rr. "Fehmi Agani", ndërsa tek të tjerat dominon një qetësi jashtëzakonisht e madhe prej ardhjes, prej ndryshimit të qeverisjes komunale. Desha t'i përshëndes dy drejtorët, të cilët kanë treguar një bashkëpunim jashtëzakonisht të madh dhe shoh se qytetarët janë shumë të kënaqur më të z. Ilirik Musliu nga Shërbimet Publik dhe z. Florian Dushi, drejtor i Drejtorisë së Inspeksionit, të cilët i kemi dedikuar mirënjojje për bashkëpunimin e treguar me ne.

Përparim Rama, kryetar vlerësoi se janë duke u angazhuar për zgjidhjen e sa më shpejtë të të gjitha problemeve më të cilat përballet kryeqyteti. Lavdërimet apo kritikat konstruktive, kontribuojnë në shtytjeje për angazhime të mëtutjeshme. Sipas tij, pas marrjes më seriozitet të kësaj problematike, edhe niveli i

Faqe 5 nga 1

zhurmës ka rënë kënaqshëm. Zhurma ka rënë në nivel të mirë. Kemi filluar me sezonin pranverë-verë, dhe jemi serioz të mos kemi probleme. Na nevojitet lëvdata me na shty përpara, por edhe kritikat konstruktive.

Shqetësim për funksionimin e Sektorit të kadastrit në Komunës e Prishtinë paraqiti **Lulzim Shehu**, përfaqësues i Bashkësisë së Tarikateve, duke thënë se probleme qytetarët vazhdojnë t'i kenë me punën e Kadastrit në Komunën e Prishtinës. Sipas tij, ky problem ka vite që nuk është zgjidhur dhe po sjellë probleme për qytetarët, sidomos probleme me pronat. Ai kërkoi nga Komuna zgjidhjen e kësaj problematike. Por shtrohet pyetja se çka nëse Komuna është burimi i problemit?! Unë jam tash e disa vjet në këtë këshill dhe problemet vetëm po vazhdojnë. Ne jemi Këshilli për siguri në bashkësi, këtu nuk bëhet fjalë për siguri fizike, po bëhet fjalë për një pasiguri, apo siguri e cenuar nga mos ligjshmërisë në domenin e Kadastrat. Problemi më prona sjell ngatërresa në mes qytetarëve, pamundësi të zhvillimit, të jetës fetare dhe problemeve të tjera të kësaj natyre. Mungon puna e kadastrit, mungon siguria e pronës, paaftësia e shfrytëzimit të pronës që e kemi. Në kuadër të kësaj pastaj mungon edhe tema, si evitimi i konfliktit, lufta kundër korruptionit etj. Ju duhet më ditë kur i qaseni si Komunë për një dokument prone, në të vërtetë jemi duke iu qasur trafikave që i kanë qelë zyrtaret atje për të na marrë gjoba për të na e kryer një punë dhe kjo deri tash nuk është sanksionuar.

Një problematikë tjetër që e potencoi Shehu është edhe çështja e qenve endacakë, dhe kërkoi nga Komuna zgjidhja e këtij problemi.

Lidhur me çështjet që i potencoi z. Shehu, kryetari Rama theksoi se janë duke punuar në rritjen maksimale të transparencës së sektorit të Kadastrit në Komunën e Prishtinës. Është mbajtur një takim me Agjencinë e Kadastrit për digjitalizim, në mënyre që më pasur qasje pa pasur nevojë me shkuar në Komunë, qasje të drejtpërdrejte për pronën. Jemi duke bërë përpjekje për të krijuar transparencë të përgjithshme. Kemi tanë edhe drejtorin e Drejtorisë së Kadastrit, z. Lushaku, i cili është shumë aktiv në këtë aspekt.

Zëvendëskryesues i KLSP-së në Kalabri, tha se edhe qytetarët e kësaj lagjeje hasin në mjaft probleme, siç është zhurma, ndërtimi i kolektorit, që ka mbetur në gjysmë, ndriçimi publik, grumbullimi i mbeturinave. Kalabria njihet si lagje më problematike, ku ballafaqohemi me probleme të mëdha tash e shumë vjet, disa zgjidhen disa jo. Zhurma është e para, e dyta, janë ato teknike, siç është ndërtimi i kolektorit që ka mbetu në gjysmë, që përbën rrezik të lartë te qasja e asaj pjese që përfundon edhe pjesa "7 Marsi", që ndodhet para hotel "Garden". Janë disa probleme në zgjidhje e sipër, siç është rregullimi i ndriçimit publik. Kemi pasur një projekt nga viti i kaluar me donacion nga OSBE-ja, edhe atë e kemi rregulluar, por ka pasur edhe projekte te vogla. Problematika tjetër është çështja e qenve endacakë. Ky është shqetësim më i madh pasi që rrezikohen nxënësit dhe banorët e asaj pjese.

Sa i përket çështjes së qenve endacakë, kryetari Rama theksoi se tash janë 8 komuna më serioze, duke u marrë me caktimin e lokacioneve për ushqimin e qenve endacakë, dhe janë duke e shtyrë këtë çështje përpëra në bashkëpunim me nivelin qendror.

Mevlude Kosumi pyeti kryetarin në lidhje me zhurmën, që është një nga shqetësimet kryesore për qytetarët që jetojnë në rrugën "B".

Kryetari Rama theksoi se sa i përket kësaj çështjeje kemi angazhimin e Komunës për rregullimin e kësaj çështjeje dhe se nga inspektorët komunalë janë dhënë vërejtjet për uljen e zhurmës dhe janë duke punuar për caktua

Faqe 6 nga 1

lartësisë sëzërit që mund të lejohet. Kemi filluar me zgjidhjen e këtij problemi. Nga vizitat e inspektoreve komunalë në ato lokale janë dhënë vërejtjet për zbritjen e nivelit të zhurmës. Me prokurimin kemi shpallur propozim për instrumente, të cilat vendosin për matjen e nivelit të decimalëve të zhurmës. Nëse vërejmë tejkalim, herën e parë do të ketë vërejtje, herën e dytë do të ketë gjobë, të tretën mbyllje të lokalit. Pra jemi në proces të rregullimit të zhurmës. me projektet shtesë do të rregullohet që në çdo restorant, çdo lokal, me kërkuar leje për muzikë. Varësisht nga kjo vendoset edhe niveli i decimilëvë të zhurmës në këto restoranteve apo bare.

Safet Kamberaj, kryesues për siguri publike në lagjen “Dardania”, tregoi se si përfaqësues i KLSP në lagjen “Dardania” kanë arritur realizimin e 6 projekteve të rëndësishme në këtë zonë, siç janë ndërtimi i platosë, pajisja me kamera në shkollën “7 Marsi”, pajisje me veshje sportive për shkollat e kësaj pjese. Ndërsa problemet kryesore përmendi se në lagjen “Dardania” janë ndotja e lartë nga mbeturinat dhe pakujdesi i qytetarëve dhe bizneseve dhe hedhja vend e pavend e papërshtatshme e mbeturinave. Ai falënderoi z. Fatmir Bilallin dhe z. Hamdi Qorri, që për 24 orë janë të gatshëm të na ndihmojnë në zgjidhjen e problemeve. Njëherësh falënderoi edhe komandanen e policisë, znj. Hoti, për gatishmërinë që tregojnë policia për bashkëpunim e profesionalizëm. KSLP-ja në Dardani ka realizuar 6 projekte, si ai në platonë në lagjen “Dardania”, pastaj kemi realizuar një projekt për shkollën “7 Marsi”, vendosjen e kamerave të sigurisë, kemi pajisur shkollën e Dardanisë me pajisje sportive në vlerën prej 7 mijë euro. Investime ka pasur edhe në shkollën “Xhemail Mustafa”, në të vërtetë aty ka qenë një investim tepër i madh, në vlerë prej 9 mijë euro. Kjo pjesë e qytetit është një katrahurë, duke filluar nga trotuaret, që nuk i plotësojnë standarde të shumicën e tyre në lagje. Impianti ka dështuar në lagjen “Emshir” që ka qenë në qeverisjen e kaluar, ka qenë i paraparë si një projekt shumë i madh. Edhe Kurrizi duhet të rregullohet.

Ai kishte edhe një kërkesë për drejtoreshën e Arsimit, duke thënë se drejtorët e përzgjedhur janë ushtrues detyre dhe sipas tij të përzgjedhur në mënyrë profesionale.

Xheladin Fazliu nga KLSP-Hajvali, theksoi se në këtë zonë problem kryesor është rruga e filluar nga “Gorenje” për në Gjilan, ku kamionët që bëjnë bartjen e produkteve ndërtimore kanë dëmtuar rrugën e ndërtuar në këtë pjesë. Kemi disa halle që dua t'i paraqesë, për të cilat qytetarët kërkojnë informacion të saktë për rrugën prej “Gorënjës”, dhe kërkojnë të dinë deri ku kanë shkuar procedurat, pasi janë bllokuar. Shqetësim nga qytetarët kemi edhe për rrugën “Dëshmorët e Gollakut” që kanë problem me ndricim publik dhe me lëvizjen e kamionëve, që janë duke punuar në lagjen “Marigona Hill”, të cilët kanë dëmtuar rrugën që është rregulluar para një viti.

Sa i përket kësaj rruge, kryetari Rama tha se janë në komunikim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, që kjo rrugë të përfundojë sa më shpejt. Për rrugën Prishtinë-Gjilan kemi pas takim me Ministrinë e Infrastrukturën dhe BERZH, ku jemi pajtuar se nga do ti bie kjo rruge. Kjo është pjesë e rrugës së unazës së mesme dhe do të përfundojë në fund të vitit, planifikohet prej marsit me dalë në tender vitin e ardhshëm. Sa i parket ndricimit publik, jemi në bashkëpunim me OSHP-në dhe shumë shpejt do të zgjidhet. Edhe çështja e kamionëve, pikë shumë me vend, kemi marrë hapa konkret me Drejtorinë e Shërbimeve Publike, që kamionët mos ta dëmtojnë rrugën dhe mos të shkaktojnë zhurmë.

Sa i përket pikës së tretë të rendit të ditës “Situata me zjarre fushore e malore”, raportoi përfaqësuesi i Brigadës profesionale të zjarrfikësve, **Malë Gashi**, i cili tha se deri më tanë kjo brigadë është duke punuar në intervenimet e nevojshme. Ai tha se në tremujorin e parë janë realizuar 133 intervenime ndaj zjarreve fushore apo malore. Numri i intervenimeve krahasuar me atë paraprak, mbetet i njëjtë. Aktualisht ka një rënje të intervenimeve pasi

Faqe 7 nga 1

ka filluar të ngrohet moti. Në tremujorin e parë kemi pasur 123 intervenime në zjarre në barë të thatë dhe në male. Problematika më e madhe ka të bëjë më zjarre në mbeturina, e sidomos në kontejnerë. Tash është bërë edhe zëvendësim i kontejnerëve, pasi që zjarri përveç që ndez mbeturinat, po dëmton edhe kontejnerët. Vitin e kaluar kemi pasur 730 internime. Deri tash numri i intervenimeve mbetet i njëjtë me atë të vitit të kaluar, tash i kemi 486 intervenime.

Sipas Gashit, bashkëpunimi është shumë i mirë më Komunën, por duhet punuar në ngritjen e vetëdijes së qytetareve për mos ndezjen e zjarreve.

Lidhur me këtë këtë çështje Rama tha se kanën një program për krijimin e Shoqatës së vullnetarëve, që do të ndikonin në ofronin e mbështetjes për aty ku ka nevojë.

Sa i përket bashkëpunimit, Kryetari i Prishtinës theksoi se do të jetë i domosdoshme një bashkëpunim i tillë.

Imi Uka, KLSP, Keqekollë dhe tri fshatra të tjera, tha se kanë mbajtur një mbledhje me policinë e Kosovës për pengimin e zjarreve, për parandalimin dhe mospërhapjen e zjarreve. Në atë mbledhje kanë marrë pjesë përfaqësues të 8 fshatrave. Ai bëri të ditur se kanë mbajtur takime edhe me drejtore të shkollave përmes lajmërimeve, bisedave që u është kërkuar, që të bëhet pengimi i zjarreve apo të lajmërohet edhe kryerësit e këtyre veprave. Uka përmendi edhe çështjen e mungesës së infrastrukturës në 8 fshatrat dhe mungesën e transportit për nxënës. Në asnjërin prej tete fshatarëve nuk është realizuar asnjë projekt. Sipas përfaqësuesit të fshatit Koliq, para 10 ditësh ka qenë edhe mungesa e transportit. Shkakun nuk e dijë, por paskan thëne se nxënësit të dalin në rruge, pasi që nuk ka mundur të bëjnë transport, që nuk ka qenë më larg se 4 km.

Përfaqësuesi i lagjes “Kalabria” tha se edhe në këtë lagje ka mjaftë probleme. “Kalabria, shtrihet si paralagje e Prishtinës, ka zonë të gjelbëruar dhe barishte dhe aty ka djegie, por ka edhe mbejtje mbeturinash nga Tregu më shumicë. Aty mbesin produktet ushqimore dhe produkte najloni me ditë të tëra. Këto produkte najloni gjatë fundjavës fillojnë dhe i djegin. Kam dërguar e-mail edhe në Ministrinë e Ambientit, kemi thirrur edhe Brigadën e zjarrfikëseve. E kisha lutur Drejtorinë e Inspeksionit që të merret më shumë me çështjen e mbeturinave.

Sa i përket kësaj çështje, nënkyetarit i Komunës, z. Alban Zogaj, theksoi se do të raportojë Habib Qorri, nga Shërbimet Publike.

Lidhur me pikën e katërt “ Përdorimi i substancave narkotike dhe bartja e mjeteve të rrezikshme”, raportoi drejtoresha e Drejtorisë së Arsimit në Komunën e Prishtinës, Besiana Musmurati.

Ajo tha se sa i përket gjendjes së arsimit në komunën e Prishtinës, gjendja e pandemisë ka ndikuar për keq në rritjen e dhunës në shkolla. Ky problem është botëror, jo vetëm në vendin tonë. Pandemia ka ndikuar që rrëth 30% e fëmijëve të kenë mësimnxenie më të ultë. Pandemia globalisht ka ndikuar që në shkolla të rritet dhuna. Këtë po e shohim edhe si Komunë e Prishtinës, po e shohim edhe si Kosovë, por edhe gjithandjej globit si fenomen, ku rrëth 30% e fëmijëve botërisht janë ndikuar negativisht që ata të kanë mësimnxenie më të ultë dhe të rritet niveli i dhunës, ku si pasojë ka edhe incidente. Kjo eshë statistikë e përgjithshme globale, prandaj mendoi që është diçka që na bënë me reflektuar edhe neve si Komunë.

Musmurati përmendi edhe bashkëpunimin e mirë me policinë e Kosovës sa i përket trajtimit të rasteve të dhunës në shkolla. Më gjzon fakti që bashkëpunimi me policinë është shembullor në Komunën e Prishtinës sa i përket sigurisë në shkolla. Takim e parë që e kamë bërë ka qenë me policinë e Kosovës dhe drejtorët e shkollave, ku na

Faqe 8 nga 1

është dhënë raport tregues për vitin shkollor 2021-2022, ku kanë qenë diku 62 raste të dhunës në shkolla, 37 prej tyre kanë qenë rreth Stacionit Policor Jugu, 18 raste tek Stacioni Policor Veriu, 6 raste tek Stacioni Policor Qendra. Këto janë statistika nga muaji i kaluar, të cilat i kam marrë nga policia e Kosovës. Incidentet kryesore kanë të bëjë me lëndime të lehta trupore, posedim të armëve të zjarrit, apo armëve të ftohta, kanosje, vjedhje dhe gjerat tjera.

Sipas saj, ajo nuk ka gjetur një raport nga Komuna sa i përket rasteve të dhunës në shkollat e Prishtinës, por ajo iu aludua një studimi të OSBE-së, i cili është bërë në fund të vitit 2021, ku thuhet se një numër i madhe i nxënësve në të gjitha nivelet, nuk ndihen aq të sigurt në shkollat e Prishtinës. Si Komunë, faktikisht nuk e kemi gjate asnjë studim apo statistikë rreth dhunës në shkolla, por është një studim i OSBE-së cili është bërë në fund të viti 2021, i cili flet shumë për sigurinë në shkolla. Studimi është bërë me 20 shkolla të Prishtinës, me rreth 500 pjesëmarrës, 150 staf mësimor dhe 150 prindër, ku thuhet se rreth 10 % e nxënësve prej klasës së parë deri në të pestën, ndihen të pasigurt në shkollë, ndërsa nxënësit e klasës së gjashtë 6 deri në të 9-ën, rreth 20% ndihën të pasigurt në shkolla. Rezjet kryesore të cilat paraqiten në raport janë ngacmimet në rrugë apo në shkolla, përlleshjet fizike dhe bullizmi qoftë verbale, qoftë fizik, për shkak se pandemia e ka rritur edhe përdorimin e smartfonëve dhe mjeteve të tjera për përdorime online. Vendet më të rrezikuara, sipas raportit dhe analizave të DKA-së, janë tualitete në shkolla dhe sallat e edukatës fizike. Ndërsa vendet jashtë shkollave janë kafeteritë dhe trafiku afér shkollave.

Sa i përket përdorimit të substancave narkotikë, Musmurati tha se nuk kam gjetur ndonjë raport, ndërsa sa i përket raportit të OSBE-së, thuhet se për nxënësit është shumë e lehtë të sigurojnë duhan, mesatarisht alkool dhe armë të lehta, dhe gati si e pamundur lëndë narkotike. Sa i përket përdorimit të substancave narkotike, nuk është se kemi gjetur raporte të gatshme si drejtori. Sigurisht duke iu referuar raporteve në fjalë, në pyetjen se sa është e vështirë që nxënësit të sigurojnë substanca, shumica e fëmijëve janë përgjigjur se është e lehtë të sigurojnë duhan, mesatarisht lehtë të sigurojnë alkool dhe armë të ftohta, ndërsa e vështirë, apo si e pamundur të sigurojnë drogë apo armë zjarri. Rrjedhimisht del se shumica e nxënësve sipas raportit, kanë qasje në duhan, pak pinë alkool, aspak apo fare drogë apo mbajnë armë. Asnjë statistikë nuk është kuantitative, gjithsesi e kanë një bazë shkencore mbi të cilin është bërë raporti. Sa i përket rekomandimeve të cilat i kemi marrë prej drejtoreve të shkollave, të cilat i kemi adresuar edhe në polici, është një kërkesë e vazhdueshme për policinë që të kontrollohen kafeteritë më shpesh.

Musmurati potencoi se drejtorët e shkollave i kanë kërkuar edhe ndalimin e shitjeve të gjësendeve të rrezikshme afér shkollave.

Sa u përket projekteve, Drejtoresha e Arsimit është në fazën fillestare për implementimin e shumë projekteve në shkollat e Prishtinës. Sa i përket komunës, jemi në fazën fillestare, siç janë rekomandimet: ndriçim, rrëthoja fizike, kamera të sigurisë në ato shkolla ku nuk ka, pasi që shumica e shkollave janë të pajisura. Barja e uniformave, jemi zotuar se do t'i adresojmë shumë shpejt. Disa tenderë kemi filluar me i shpallur për rrëthoja me ndriçim dhe kamera. Kemi dy projekte kapitale në shkolla dhe investimet në cilësinë e arsimit. Shkollat me të mitur kërkojnë një trajtim më delikat.

Musmurati theksoi edhe rëndësinë e luftimit të bullizmit dhe prezencës së më shumë psikologëve në shkolla. Do ta krijojmë Task-forcën për siguri në shkollë, në mënyrë që të raportojmë si një rast kur duhet të lajmërohet tek prindi, kur në DKA nuk kemi një fazë operimi se si raportohen rastet. Do të fokusohemi të luftojmë bullizmin

Faqe 9 nga 1

dhe faktorët që ndikojnë tek fëmijët në shkolla të ndryshme. Fatkeqësish, një psikolog nuk mundet të trajtojë aq fëmijët sa ka nevojë. Bashkë e me Ministrinë Arsimit do të punojmë në këtë drejtim, që të ketë më shumë psikologë.

Ndërsa sa i përket pyetjes së mëhershme se shumë drejtorë vazhdojë të janë ushtrues detyre, drejtoresha e Arsimit tha se ka një numër të vogël që janë ushtrues detyre të drejtorit dhe ajo premtoi se do të angazhohet që punësimet mos të janë të ndikuara politikisht. Ajo bëri të ditur se po bashkëpunon edhe me Ambasadën e Shteteve të Bashkuar, që në pozitat menaxheriale punësimet të janë sa më korrekte. Ndërsa sa i përket transportit në fshatrat e largëta të Prishtinës, theksoi se është një rregulllore e cila ndalon transportin e nxënësve kur gjatësia është më afër se 4 km. Sipas saj, ajo do të mundohet ta zgjidhë këtë çështje, por duhet të ndryshohet edhe rregullorja që e trajton këtë çështje, në veçanti në fshatrat që të lejohet transporti i nxënësve edhe ne hapësira më të afërta.

Përfaqësuesi i KLSP-së, Kaqandollë, me tre fshatrat për rrith, kërkoi nga DKA që të mos kursehet buxheti kur bëhet fjalë për nxënësit në zona malore, por të behet transporti i këtyre nxënësve.

Drejtoresha Musmurtai iu përgjigj se çështja është tek aspekti ligjor, që do të përpinqemi ta rregullojmë.

Përfaqësuesi i Policisë, tha se policia nuk është ndalur në ofrimin e sigurisë në shkolla, njëherësh ka ofruar edhe ligjérata për përdorimin e substancave narkotike. Pikat kyçe që na kishin ndihmuar policia ofrimi i sigurisë në shkolla dhe ofrimin e ligjératave për siguri në shkollat e mesme dhe fillore, për dhunën në baza gjinore, substanca narkotike, ligjérata për dhunën në familje etj. Të gjitha këto ligjératat janë mbajt prej policisë, që kanë ndikuar në vetëdijesimin e të rinjve për sigurinë në përgjithësi.

Përfaqësuesi i KLSP Hajvali, tha se në këtë lagje dy shkolla i kanë pajisur me kamera, po ashtu edhe Këshillin e prindërve e kanë angazhuar në ofrimin e sigurimit private për nxënësit e shkollave. Në Hajvali kemi dy shkolla, fillor të mesëm dhe të ultë, falë projektit që e kemi bërë KLSP, që dy shkolla i ka pajisur me kamera. Kjo është për t'u përshëndetur. Në shkollën "Shkëndija" kemi marrë një iniciativë me Këshillin e prindërve. Kërkesë e prindërve ka qenë për angazhimin e një kompani që e bën monitorimin e nxënësve.

Ai shtroi pyetjen se a kanë të drejtë këto kompani me i monitoruar nxënëset qoftë para hyrjes, apo gjatë daljes nga procesi mësimore, pasi që qasja e kompanisë ka qenë jashtë oborrit të shkollës.

Përfaqësni i Këshilli të prindërve, Jeton Demi, tha se është shumë më rendësi që të përcillen lokalet afër shkollave të Prishtinës. Për shkak të rreziqeve që paraqiten në afersi të shkollave dhe atyre në periferi, prezenca e policisë është e domosdoshme. Është tjetër çështja e lokaleve afër shkollave, të cilat janë bërë baza të veprave kriminale. Kam parë duke bërë kontrollle policia dhe vazhdoi të insistoj, për çështje e narkotikeve kemi adresim të vazhdueshme dhe të përditshëm, modele të caktuara të cilat mund të zbatohen. Si mund të trajtohen çështja e lokaleve, pasi që 10 vjet lokalet ku kushtet sanitare i kanë të dobëta, edhe për shkak të lëvizjes edhe te prezencës fizike. Dyshojmë se disa nga bizneset janë duke kryer veprime të afarizmit të pastandardizuar, kemi raste të helmimit të fëmijëve. Këto nuk do të ndodhin nëse marrim masa parandaluese. Është e nevojshme që të përmendim edhe transportim me kombinues, që veprojnë pa ndonjë standard, nuk kanë staf që t'i përbushin disa kushte dhe raportimet nga përvoja që kam pasur, bëjnë dërgimin e fëmijëve jashtë standardit.

Faqe 10 nga 1

Përfaqësuesi nga Këshilli i prindërve, z. Demi, tha se si problem i theksuar mbetet mungesa e parkingjeve afër shkollave, dhe kerkoi nga policia që të kenë një mirëkuptim për prindërit që i sjellin nxënësit në shkolla, që të mos marrin dënimë për këtë shkak.

Hatem Kupina, KLSP Bardhosh, kerkoi që për çdo adresim të kthehet përgjigje përmes procesverbalit në mbledhjen e ardhshme. Ai kerkoi që të mblidhen shënime dhe që drejtoritë të përgatisin një plan strategjik. Ai propozoi më qenë të suksesshëm, që sfidat me i qitur në letër, me i adresuar në drejtoritë e caktuara. Drejtoritë në procesverbal na i kthen përgjigjet. Të gjitha pyetjet të cila i kamë përgatitur i zëre në gojë. Kam një kërkësë, që jo vetëm ju edhe Drejtoria e Shëndetësisë të përgatisni nga një plan strategjik, që dhe drejtoria përkatëse ta bëjë zgjedhjen. Kjo që flasim është mirë, por gjysma s'mundemi me i mbajtur mend, qëllimi është me qenë të suksesshëm, efikas dhe produktiv në punën tonë, planin e veprimit.

Ai paraqiti edhe një problematikë, atë të Klubit të ushtrimit, afër shkollës " Andon Zako Cajupi". Njëherësh kerkoi që në fshatin Bardhosh të bëhet edhe ndërtimi i çerdhes publike, që është e domosdoshme.

Në pyetjen e Përfaqësuesit të Hajvalisë se a lejohet qasja e sigurimit në kontrollimin e nxënëseve në çantat e tyre, drejtoresha e Arsimit tha se do të analizojë këtë çështje se sa mund të kenë të drejtë sigurimi të kontrollojë nxënësit e shkollave. Ajo theksoi se shkolla "Shkëndija" është një shembull i mirë i sigurimit. Sa i përket shkollës në fjalë, është shembulli më i mirë se ka mungesë të thellë të standardizimit të sigurisë në shkolla. Nuk jam e sigurt a është veprim i ligjshëm, a kanë të drejtë me i kontroll çantat e fëmijëve. Është një rregullore, e cila është e miratuar, edhe ajo të plotësohet brenda se cilës shkollë, se jemi duke punuar, që të jetë standardizim, çfarë kompetence ka roja, ku mundet roja me drejtuar çantën, kur të lajmërohet DKA-ja në bashkëpunime me policinë e Kosovës. Prindërit në vetë kanë bërë zgjidhje të zorit. Sa i përket transportit, do të trajtojmë me shumë prioritet, kontrata të bëhet me standarde më të lartë, ku fëmija ka ulësen e vet, i cili angazhohet nga komuna e Prishtinës, për transportin e fëmijëve.

Sa i përket gjendjes me pandeminë, sqaroi drejtori i Shëndetësisë në Komunën e Prishtinë, z. Izet Sadiku, i cili tha se gjendja aktuale me pandeminë është e mirë dhe se numri i rasteve aktive me virusin COVID-19 është shume i vogël. Kjo rënie ka ardhur si rezultat edhe i vaksinimit të qytetareve. Fatmirësish Prishtina dhe e tërë Kosova qëndron në një situatë të mirë epidemiologjike, numri i të infektuarave është shumë i vogël krahasuar edhe me disa vende të rajonit dhe vende të tjera. Po ju jep disa informata, disa statistika për me pa ju si ka qenë situata. Ju e dini që rasti i parë në Kosovë që është paraqitur, është më 13 mars 2020, është bërë gati 25 muaj që ne e kemi pasur rastin me COVID -19. Deri më sot Kosova i ka 227780 raste me COVID -19 dhe ka 3138 raste të vdekjes. Prishtina si qyteti më i madh sigurisht se e ka edhe numrin më të madh të rasteve me COVID -19 dhe nga 13 marsi, kur është paraqitur rasti i parë, deri me 14 prill, Prishtina i ka 70 029 raste me COVID -19, apo 30.7% e rasteve që ka qenë në nivel të Kosovës. Ka pasur 69 459 raste të shëruara , apo 99 % rasteve të të infektuarave në Prishtinë janë shëruar, që i bie mesatarja për këta 25 muaj ka qenë 2800 raste, nëse e shpërndajmë për muaj, edhe pse e dimë se kjo nuk ka qenë situatë e njëjtë për çdo muaj, pasi që ka pasur raste që kanë qenë 10 deri 15 mijë, dhe ka muaj që kemi pasur 1000 apo 500. Nëse e bëjmë një shpërndarje në bazë të muajit, i ka ra që 2800 raste në muaj t'i ketë Prishtina. Prishtina ka pasur 465 raste të vdekjes, apo që i bie 0. 6 raste të vdekjes, që statistike është një numër i vogël krahasuar me numrin e të infektuarve, që i bie se as 1% e të infektuarave nuk ka vdekur nga sëmundja. Në mjkësi kjo përqindje konsiderohet si vdekshmëri e shkallës së ultë.

Faqe 11 nga 1

Menaxhimi i mirë i pandemisë ka rezultuar si rezultat i bashkëpunimit në mes qytetarëve, institucioneve shëndetësore, policisë dhe FSK-së. Kjo falë punës që kanë bërë institucionet shëndetësore në Prishtinë, qendrat e mjekësisë familjare. Një falenderim të veçante për qytetaret në përgjithësi, pasi që kontributi i tyre ka qenë i jashtëzakonshëm. Ky bashkëpunim i institucioneve dhe qytetarëve, Kosovën sot e nxjerr, edhe pse nuk është bërë ndonjë hulumtim, por sigurisht se ka me nxjerrë në një vend të suksesshëm në trajtimin e pandemisë me COVID -19. Të gjitha institucionet shëndetësore, edhe policia, FKS-ja dhe qytetaret, ka qenë vendimtare në këtë bashkëpunim, duke u bazuar edhe në sistemin shëndetësor që kemi ne. Duhet pranuar që Kosova ende nuk e ka një legjislacion për të dëshiruar, i cili në pandemi hyri me shumë të meta, por që i ka përballur. Duke iu falenderuar këtij bashkëpunimi të përgjithshëm, ka arritur me menaxhuar mirë pandeminë. Mesatarja e vdekjeve mujore ka qenë 18 raste, do të thotë që mesatarisht nga fillimi i pandemisë kemi pasur 18 të vdekur nga COVID -19 në Prishtinë. Numri i rasteve aktive në Prishtinë sot është 105. Ndoshta dhe këto janë informata të tilla, por numri më i lartë i të infektuarve ka qenë në periudhën janar - shkurt, për shkak se kemi pasur të bëjmë me një variant të ri të SARS-COV 2, që e shkakton COVIDI, që ka qenë shumë më infektues se variantet e tjera dhe kemi pasur diku 7500 raste të reja për muaj, që nuk kanë qenë karakteristike. Ndërsa vdekshmëria në nivel Prishtine, ka qenë 18. 6, ndërsa në dy muajt e fundit ka qenë 10.6, që tregon se varianti OMICRON, përkundër numrit të madh të infektuarave, numri i të vdekurave ka qenë shumë më i vogël, pra që format e tij kanë qenë më të lehta. Ai ceku edhe shërbimet që kanë dhënë institucionet shëndetësore në Prishtinë gjatë viti 2021 dhe vitit 2022. Gjatë viti 2021, nga 1 janarit deri më 31 dhjetor, në Qendrat e Mjekësisë Familjare janë trajtuar 35 000 pacientë pozitivë, 22 458 të dyshuar pozitivë, dhe pacientë me rezultat negativ 7950. Pra komplet shërbimet që i kanë marrë kanë qenë 66 333 pacientë.

Ai tha se të gjithë qytetarët që kanë pasur nevojë, kanë marrë shërbimin e duhur gjatë pandemisë. Nuk besoi që ka qytetarë në Kosove dhe Prishtinë që ka kërkuar shërbim për COVID dhe nuk ka marrë. Përkundër vështirësive që ka pasur, sidomos në vitin e kaluar, shtatori ka qene tmerrësish i ngarkuar, ju e dini që kanë qenë mbi 1300 raste të hospitalizuar në Kosovë. Dhe përkundër kësaj nuk është mbetur asnjë, ndoshta kanë munguar shërbimet cilësore, por ne e dimë çfarë shërbimesh kemi, andaj mendoj se kjo është një sukses. Sa i përket këtij viti, për këta dy muajt e kaluar ne kemi pasur 2400 raste që kanë marrë shërbemë për COVID, ndërsa në muajin mars kemi pasur vetëm 66 raste. Kjo tregon për një rënje drastike të numrit të kërkuesave për shërbime shëndetësore dhe numrin rasteve që e kemi sot që e përmenda, që kemi 105 raste, dhe ju e dini që falë kësaj situatejeta në Kosovë, zhvillohet sikur para pandemisë, nuk kemi kufizime dhe masa të tjera.

Drejtori i Shëndetësisë vlerësoi se Qendrat e Mjekësisë Familjare kanë qenë më të ngarkuara edhe për shërbime të tjera në nivel vendi. Ambulancat e Mjekësisë Urgjente prej fillimit kanë asistuar në bartjen e pacientëve jo vetëm të Prishtinë. Ju kujtohet koha e karantinës që ka qenë, për çdo rast janë merr ekipet e emergjencës, një punë shësë, një ngarkesë për punëtoret shëndetësor. Një informatë e rëndësishme sa i përket sa kemi, ka qenë edhe testimi me COVID -19 dhe ne realisht kemi 19836 testime gjatë këtij viti, ndërsa gjatë viti 2021 kemi pasur 50 mijë testime. Në Janar kemi pasur 9 647 testime, ne muajin shkurt 7 000.

Sa i përket vaksinimit, Drejtori Sadiku tha se procesi tash është decentralizur edhe qendrat e tjera të Mjekësisë Familjare. Sa i përket vaksinimit, duhet me ditë që prej dhjetorit është bërë një decentralizim, që është shpërndë vaksinimi të behet dhe nëpër qendra të tjera, jo vetëm në një qendër për krejt Prishtinën. Kemi marrë sugjerim dhe vërejtje që kjo të mos bëhet vetëm në një qendër. Ne dimë që qytetarët marrin vaksina dhe administrimi i COVID -19 nuk dallon nga administrimi tjetër i vaksinave. Kur ka filluar vaksinim në muajin Mars të vitit të

Faqe 12 nga 1

kaluar, ka qenë ndoshta që është dashur të mbahet si procedurë, është në një qendër, por me kohë është decentralizur, me qenë sa më afér qytetarit, e rrësim gatishmérinë e qytetarit me marrë vaksina. Realisht na ka rënë kjo gatishméri. Në dhjetor na është mbyllur ajo qendra dhe është hap në Kalabri, që e kemi pasur qendrën kryesorë ne Prishtinë. Pastaj, varësisht prej kërkesave të Ministrisë së Shëndetësisë kemi hapur edhe qendra tjera. Ne kemi hapur qendra në lagjen “Kodra e Trimave”, pastaj një në sheshin “Zahir Pajaziti”, një në “Albi Mall” dhe ka qenë një në Aeroportin Prishtinë. Këto qendra kanë bërë vaksinimin e qytetarëve. Realisht gjatë këtyre muajve, si p.sh. në janar kemi pasur 18 912 vaksina, në shkurt 5504, në mars 1684 dhe në këto dhe dy trembëdhjetë 340 vaksina, që ka filluar me rënë numri. Në këtë drejtum mund të diskutojmë që kontributi i juaj mund të jetë i mirëseardhur që me biseduar dhe me i ftuar qytetarët për me u vaksinuar, për arsy se edhe duke ju falënderuar vaksinave, kryesisht e kemi këtë situatë të cilën e kemi sot, që krahasuar para një viti ose dy me krahasuar qysh ka qenë Kosova me COVID-19, por duke iu falënderuar numrit të madh të vaksinave. Në Prishtinë deri me tanë janë administruar rrëth 300 000 vaksina, 256 600 mijë janë administruar vetëm vitin e kaluar dhe këtë vit i kemi 29 mijë, 30 mijë vaksina që janë administruar për këta tre muaj e gjysmë të këtij viti, por këtu ne si Drejtori e Shëndetësisë, edhe pse po them se është e pozicionim për krejt mënyrat bahan fushatat si bahan, ne e kemi sugjeruar Ministrinë e Shëndetësisë, që jemi të gatshëm të involvuar dhe jemi të interesuar që këtë komponentë me i involvuar jo vetëm mjekët, por krejt komponentët e shoqërisë, duke filluar edhe nga predikuesit, klerikët që kanë një ndikim shumë të rëndësishme tek qytetarët, tek policia, tek FSK-ja, për arsy se sa më shumë faktorë që implikohen në administrimin e nevojave për vaksinim. Fatbardhësisht, secili prej juve ka dhënë një kontribut për këto dy vite të drejtpërdrejtë për menaxhimin e pandemisë COVID -19.

Duke iu falënderuar për gjithë këtë bashkëpunim, duke filluar nga institucionet shëndetësore, që ka pasur barrën kryesore për të mbrojtur qytetarët, mendoi se sot kemi një situate të mirë në Kosovë, por që mendoj me më mbajt në kontroll pandeminë duhet me rritur numrin e të vaksinuarve.

Përfaqësuesi i lagjes “Kalabria” kishte një kërkese për Qendrën e Mjekësisë Familjare në këtë lagje. Ai kërkoi shtimin e kapaciteteve mjekësore dhe shërbyese, si dentistë, gjinekolog.

Hatem Kupina, përfaqësuesi i KSLP-së në Bardhosh, kërkësë në emër të qytetareve. AMF-ja jonë ka punuar në dy ndërresa në kohën kur ka qenë drejtor z. Vitia. Tani punon vetëm një ndërresë. Kërkojmë që sa më shpejt me aktivizuar AMF-në me punuar në dy ndërresa, por mundësish edhe të shtunave dhe të dielave.

Dr. Izet Sadiku, drejtor i Shëndetësisë, theksoi se sa i përket Qendrës së Mjekësisë Familjare në lagjen “Kalabria”, është e vërtetë se krejt QMF-ja është marrë atje, kjo për arsyje se është vendosur në dhjetor, kur është mbyllur qendra e vaksinimit në sallën “1 Tetori” dhe është vendosur me qenë një qendër për fillim, është vendos në katin e dytë, por në fund është parë se nuk kishte ashensor dhe qytetarët e moshuar kanë pasur problem me ngjitje në katin e lartë. Realisht, mbylljen e këtyre qendrave nuk kemi të drejtë me bërë ne. Ne po diskutojmë që qendrat për vaksinim me u bërë në çdo ordinancë dhe po mendojë që shërbimet që kanë atje me u kthyer. Është shumë me rëndësi të dihet se, që nga marsi i këtij viti kanë arritur që me ofruar shërbime për vizita në shtëpi nga 4 ekipe. Sigurisht se ne kemi arritur me i kthyer ato shërbime. Nga 1 marsi i këtij viti ne kemi rritur shërbimin për sëmundjet kronike, i cili po funksionon në Lagjen e Muhxhirëve, dhe ai shërbim për 1 mars ka 4 ekipe në ditë, gjatë 12 orëve, secili ekip ka nga dy pjesëtarë dhe vetëm gjatë një muaji kemi rritjen e kërkesave për vizita shtëpiake, prej 460 sa kanë qenë në 12 muajt e fundit, ku vetëm në muajin mars kemi pasur 760 raste kemi ngritje. Ju mund t’i informoni qytetarët se të gjithë ata që kanë nevoje me marrë shërbim në shtëpi, infuzion,

Faqe 13 nga 1

terapi, vizitë mjekësore ose për një arsy shëndetësore a mund të shkojnë në qendrat e Mjekësisë Familjare, ekipi 7 ditë të javës nga 12 orë është në gatishmëri me bërë vizita në shtëpi. Ne rast se këto kërkesa do të rriten, ne do t'i rrisim ekipet. Është gatishmëri e kryetarit me i rritur këto ekipe, në mënyrë që të ofrohen shërbime sa më të mira për qytetarët e Prishtinës, sidomos me ata më sëmundje kronike, janë moshë shtyrë.

Ilmi Uka, përfaqësues i KLSP-së në Kaqandoll, Koliq dhe Dabishec, kërkoi që ky shërbim të ofrohet edhe për fshatrat e Prishtinës. Ai shtroi pyetjen se a keni paraparë një gjë të ngjashme edhe për zonën rurale. Për vizita në shtëpi, për infuzione, sepse në bashkësinë lokale të Dabishevc një herë në javë shkon mjeku, në Koliq shkon tri herë, në Keqekollë 5 herë, por nuk e ka orarin e plotë. Prandaj këto shërbime janë të nevojshme edhe për zonën rurale.

Drejtori Sadiku tha se kjo vlen për gjithë qytetin e Prishtinë pa dallim. Sigurisht se ky shërbim nuk është vetëm për qytet, por vlen për të gjitha zonat. Ata që janë më astmë, që do të thotë se nuk mund të shkojnë vet për të marr shërbim mjekësor, duhet ta thërrasin shërbimin e qytetit, pra për ata që janë me sëmundje kronike, që për ndonjë arsy nuk mund të marrin shërbime ose janë pacientë me nevoja urgjente, që është urgjencia, e cila punon 24 orë dhe sigurisht se çdo qytetari mund t'i ofrohet shërbimi me ju përgjigjur drejtori i Shëndetësisë.

Në pikën e 6-të të rendit të ditës u diskutua për gjendjen e qenve endacakë, me ç'rast, **Habib Qorri**, nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, tha se problemi i qenve endacakë është një problem i kamotshëm, me të cilin ballafaqohen qytetarët e Prishtinës. Është duke u punuar me të gjitha institucionet për gjetjen e zgjidhjes sa më të shpejtë për të trajtuar këtë problem. Të gjitha mbledhjet e KKLSB-së kjo temë është trajtuar dhe çdo herë kemi dhënë kontributin si Komunë në bazë të ligjeve dhe udhëzimeve administrative për trajtimin e këtij problemi. Problemi me qentë endacakë nuk është vetëm i një niveli, pasi i tejkalon edhe kufijtë e komunës së Prishtinës, deri në nivel vendi, i cili për fat të keq në nivel vendi deri më tanë ka dhënë shumë pak rezultate në trajtimin e këtij problemi. Edhe shumë herë që kemi kërkuar nga niveli qendror, sikur të ishte trajtuar në nivel qendror ashtu si e ka trajtuar Komuna e Prishtinës, jam shumë i bindur se këtë problem nuk do ta kishim në këtë shkallë kaq alarmante dhe kaq të vështirë për qentë endacakë. Duke u bazuar në këtë, vazhdimesh kemi sulme të qenve dhe shtim të numrit të qenve endacakë nga burimet e ndryshme, që janë pronarët që i mbajnë një kohë e pastaj i lirojnë qentë dhe shtimi i tyre është prapë i pakontrolluar.

Duke u bazuar në këto, kryetari i Komunës është në gjendje gatishmërie emergjente, për çka ka ngritur edhe Task-forcën për trajtimin e këtij problemi. Pas krijimit të Task-forcës si ekip, ne kemi kontaktuar dhe kemi bërë takime me të gjitha institucionet relevante, që asnjëherë me parë nuk ka qenë në këtë shkallë të gatishmërisë dhe angazhimit, përfshirë të gjitha ministritë, Zyrën e Kryeministrit, organizata të ndryshme jo qeveritare që merren më këtë problematikë, në mënyre që të marrim rekomandimet e tyre dhe të vijmë deri tek një zgjidhje sa ma e mirë, në mënyrë që ky problem të zgjedhjet gradualisht, pasi që menjëherë është e pamundur. Ne kemi lidhur një kontratë emergjente, që është vazhdimesia e tyre, që kanë qenë më herët krastrimi dhe sterilizimi i qenve endacakë dhe që është një masë parandaluese për shumimin e tyre.

Z. Qorri tha se janë duke punuar me të gjitha institucionet, me qëllim që të gjejnë një zgjidhje afatgjate. Janë duke punuar me Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinës dhe inspektorët e nivelit qendror, që strehimoret që janë duke u mbajtur në mënyrë të paligjshme nga jashtë territorit të Prishtinës, por që impakti i tyre është i drejtpërdrejtë në komunën e Prishtinës. Qentë lëvizin në momentin që dalin jashtë dhe vendi më i mirë për të jetuar për ta po del se është Prishtina, pasi që ka mbeturina, ka vende ku mund të ushqehen. Në bazë të kësaj

Faqe 14 nga 1

kemi marrë sugjerime nga ekspertët, përveç që kanë qenë pesë pika ushqyese të qenve, janë shtuar edhe 18 të tjera, për arsy se ka qenë rekomandim, ata nuk janë të uritur, agresiviteti do të bie dhe sulmet do të jenë në shkallë më të vogël. Pastaj e kemi proceduar, edhe pse ka dështuar dy herë ndërtimi i qendrës për trajtimin e kafshëve, në zonën e Hajavalisë, tash për të tretën e kemi proceduar dhe mendojmë që në strategjinë afatmesme, do të bëjmë një zgjidhje të këtij problemi, për arsy se kjo do të ofrojë shërbim çdo ditë gjatë 24 orëve.

Sipas z. Qorri, është shumë me rëndësi të potencohet edhe planifikimi i ndërtimit të Qendrës, apo strehimores për trajtimin e të gjithë qenve endacakë, me të cilën do të zgjidhej problematika e qenve endacakë. Kemi proceduar edhe ndarjen e 10 ha për ndërtimin e Qendrës, strehimores, ku do të ofrohen shërbime dhe aktivitete të ndryshme. Me këtë Komuna planifikon që të bëjë zgjidhjen përfundimtare, që të arrihen rezultate për zvogëlimin e këtij problemi, ose numri i qenve endacakë të jetë në nivelin e kontrolluar. Ligjërisht nuk kemi formë tjetër përveç se t'i lirojmë dhe t'i kthejmë prapë në vendin ku janë marrë më parë. Me ndërtimin e kësaj qendre apo strehimoreje që planifikohet të behet, mendojmë që ky problem do të zgjidhet një herë e përgjithmonë në Komunë e Prishtinës. Mirëpo në vazhdimisht jemi duke kërkuar nga niveli qendror dhe nga Asociacioni i Komunave të Kosovës, që në nivel vendi të trajtohet ky problem. Ne si Komunë për shkak se ka informacione të ndryshme, qoftë nga OJQ-të qoftë nga burimet e tjera, edhe komunat për rreth të cilat nuk e trajtojnë, ardhjen apo migrimin e tyre në Prishtinë e që është në shkallë të lartë. Për këtë kryetari i Komunës ka kontaktuar me komunat e regionit, që së paku në nivel rajonal të trajtohet dhe të fillojë të bie numri i qenve endacakë. Me këtë zvogëlohet edhe problemi.

Alban Zogaj, nënkyetar i Komunës, lidhur me çështjen e qenve endacakë, tha se qytetarët në vazhdimësi na pyesin lidhur me trajtimin e qenve endacakë. Ata nuk kanë njohuri sa i përket barrierave që përbën baza ligjore dhe barrierat ekzistuese. Ata kërkojnë largimin e qenve endacakë nga rrugët dhe kjo është kërkesë legjitime e qytetarëve. Nuk mundemi me i hequr pasi që nuk kemi ku me i dërguar. Me i hequr nga rruga duhet me pasur një adresë se ku i dërgon, pa e ndërtuar strehimoren, që ne veç kemi filluar ta ndërtojmë, nuk kemi ku t'i dërgojmë qentë endacakë. Tjetra është që Ligji përmbrojtjen e kafshëve nuk na lejon dhe nuk duhet në fakt që ne të bëjmë ndonjë veprim tjetër ndaj kafshëve në komunën tonë. Andaj, e vetmja formë e zgjidhjes është kjo që ne po e bëjmë aktualisht, e sidomos, siç e tha z. Qorri, një strehimore ku do të strehohem me mijëra qenë do të na e lehtësoi punën në rrugët e qytetit.

Violeta Hasani, përfaqësuese e KLSP-së në Qendër, tha se sa i përket OJQ-ve të cilat fitojnë projekte nga institucionet e ndryshme duhet të merren më seriozisht me këtë çështje. Sa i përket OJQ-ve, a është duke i kontrolluar këto OJQ, të cilat nuk janë duke bërë asgjë, pasi që, me sa jam në dijeni, qoftë nga nivelin qendror qoftë nga ai lokal, mjaftueshëm financohen, por sa i përket shërbimit me marrë prej qytetarëve nuk është vetëm Komuna që duhet me bë dicë, këtu duhet të gjithë së bashku me zgjidhur këtë problem, sepse me të vërtete është një problem urgjent. Unë jetoi ne Qendër dhe mbi 30 qenë i ke në ora 7 e 30 kur dal, dhe ka ndodh me thirrur përfaqësuesin e OJQ-së, që s'dua me ia përmend emrin, dhe as që u përgjigj. Rasti ka qenë mjaftë serioz është dashur me u përgjigjur, derisa në anën tjetër thirret si përfaqësues i OJQ-së.

Përfaqësues i lagjes “Kalabria” tha se në lagjen te Tregu me shumicë, problemit me qentë endacak i kontribuojnë edhe thertoret të cilat i joshin qentë me kockat e mbetur. Pra në lagjen tonë, në pjesën e prapa të saj është edhe thertorja e kapaciteteve të mëdha e që kam pasur problem me ta, pasi ata derdhin mbeturina, pjesërisht gjakun dhe ato mbetjet e brendshme në kanalizim, ku kanalizimi është i Amortizatorëve, e përqon dhe

Faqe 15 nga 1

derdhja bëhet në lumin Prishtina. Unë s'jam kundër pronarit, por ai standardizim nuk ka dhe nuk ka të drejtë me derdh aty. Na ka ndodh me u bllokuar kanalizimi nga mbetjet e tij dhe aty i keni shënimet e inspektorit tuaj komunal, ku janë detyrua pastaj me radhë me brëë larjen përmes komponentëve dezinfektuese të lagjeve. Kemi qenë në rrezik. Në verë ka ndodhur kjo. Mendoj që ai nuk e ka vendin aty, e ka diku tjetër, me largu ose m e dalë diku më në periferi, sepse aty është shumë afër qytetit dhe kemi shkolla të mesme afër, si Shkolla e Bujqësisë dhe Shkolla e Ekonomisë. Qentë janë aty afër, që paraqesin rrezik për të gjithë.

Z. Zogaj, nënkyetari i Komunës, tha se do ata marrin parasysh këtë kërkesë dhe do të marrim masa. Do të shikojmë çfarë mund të bëjnë karshi kësaj problematike.

Abdusamed Shkodra, qytetar, tha se shpesh më ka rastisur që të shohë qen të ngordhur ne rrugë, që mbesin aty për një kohë më të gjatë. Unë desha ta ndërlidhi këtë shqetësim dhe të pyes se a ka Komuna e Prishtinës ndonjë kompani të kontraktuar që i trajton qentë e aksidentuar e të mbetur në rrugë, se është rreziku që këta qytetarë mund të infektohen prej tyre.

Habib Qorri, nga Shërbimet Publike, tha se nuk ka ndonjë kompani të veçantë me trajtuar, por që Drejtoria e Shërbime Publike çdoherë bënë largimin e qeneve të ngordhur. Nuk ka kompani të caktuar për largimin e qeneve nga rruga, mirëpo operatori apo kompanitë në momentin që marrim informatën, gjatë punës së tyre hasim në largimi e tyre menjëherë. Apo përmes qendrës për informim 24 h, bëhet lajmërimi dhe kompania e ben largimin e tyre.

Mal Gashi nga Brigada e Zjarrfikësve tha se ndodh që qytetarët shpesh i thërrasin për largimin e qeneve, por ata nuk dinë se ku duhet t'i drejtojnë.

Nnëkyetari Zogaj tha se në raste të tillë të lajmëroni Komunën për të ndërmarrë masa.

Skënder Pestreshi, përfaqësues i OJQ-ve në KKSB, tha se për trajtimin e qeneve endacakë duhet një bashkëpunim më i madh i të gjitha institucioneve. Sipas tij, niveli qendror duhet të bashkëpunojë me komunat për të bërë sa më efektiv trajtimin e qeneve endacakë. Unë jam i fushës së sigurisë e jo i fushës së qeneve endacakë. Edhe unë jam pronar i qenit dhe gjatë ditës kur dal me shëtitur vërehen probleme. Një sfidë e madhe me vite të tëra është edhe a janë ndarë projekte për trajtimin e qeneve endacakë, qoftë për kastrimin, regjistrimin apo edhe sterilizimin e tyre. Mirëpo problem ka qenë edhe mbikëqyrja e kontratave. Jo vetëm për kontratat për trajtimin e qeneve, por edhe kontratat në prokurim publik dhe në nivel qendror. Ka rëndësi të madhe mbikëqyrja, kualiteti se po bëhet shërbimi apo ja merr operatori ekonomik, apo e kryen ashtu siç duhet. Se kemi vërejtur që ka bashkëpunim, disa kompani që i marrin kontratat që i kryejnë shërbimet për qentë, nuk i kryejnë ato shërbime andaj edhe lëvizin. Është një sfidë e madhe që po ju ndërrohen adresat qeneve, pasi emergjente është nëse në një mëhallë janë 30 qenë, të bëhet një zps 15, në mënyrë që të ulet numri i qeneve që jetojnë bashkë në një komunë apo edhe rreziku prej tyre të bie. Sfidë e tretë që qytetarët të kontribuojnë qoftë me mjetet financiare, ndoshta iniciativa e Komunës, e kryeministrit me AUK-in, me i regjistruar, me i krastruar është një ndihmë. Personalisht kemi arritur me krijuar 1000 euro fonde për me adresuar. Ka shumë vullnetarizëm, por ka munguar vullneti i institucioneve. Unë jam i bindur që nëse bëhet ndonjë qendër e madhe, nuk mungon vullneti i qytetarëve për me reaguar.

Safije Baseni, përfaqësuesi i KLSP-së së lagjes “Dodona”, pyeti se kur do të bëhet ndërtimi kësaj strehimoreje. Ajo kërkoi një afat kohor dhe jo të mabetet vetëm diskutim i mbledhjeve në këtë këshill. Këtë problem e kemi me

Faqe 16 nga 1

vite. Vazhdimisht do të bëhet strehimorja thoni, po a është një datë se kur do të ndërtohet. Sepse përgjegjësitetë po mbesin duke u bartur nga një mbledhje në mbledhjen tjetër.

Nënkyetari Zogaj tha se në mbledhjen e Kuvendit të Komunës veçse është caktuar hapësira dhe tashmë priten procedurat tenderuese për me shpall kompaninë që do të bëjë ndërtimin e kësaj strehimoreje. Në mbledhjen e kaluar kemi caktuar lokacionin, jemi duke e shikuar ligjshmërinë. Edhe procedurat e tenderave na marrin kohë. Në këtë mandatë e kemi marrë parasysh dhe këtë mandat besoj se do ta zgjidhim këtë çështje.

Në pikën e fundit u diskutua për çështje të ndryshme, ku nënkyetari, z. Alban Zogaj kërkoi që të paraqiten edhe kërkesat e të pranishmëve për mbledhjen e radhës.

Përfaqësuesi i KLSP-së në Bardhosh, Hetem Kupina, kërkoi nga Drejtoria e Inspeksionit që të bëjë ndalimin urgjent të therjes së kafshëve dhe gjuajtjen në e mbeturinave në lumenjtë e fshatrave.

Ai kërkoi edhe nga Drejtoria e Pronës që të bëjë zgjidhjen e varrezave të komunitetit egjiptian dhe ashkali.

Jeton Demi, Këshilli i Prindërve, kërkoi që të bëhet edhe ndalimi i duhanpirjes në vendet publike.

Demi po ashtu shtroi edhe një kërkesë në lidhje me arkivimin e pagesave për tatim. Sipas tij, kjo aktualisht nuk funksionon në Komunën e Prishtinës, që paraqet mundësi për keqpërdorim. Çështje tjetër ngriti edhe ndalimin e shitjeve të pijeve energjetike afér shkollave.

Safet Kambëraj, KLSP në Dardani, kërkoi që kërkesat me i adresuar tek drejtori të e Komunës përmes e-mailit.

Në këtë pikë, nënkyetari Zogaj tha se kërkesat munden të drejtohen tek ai zyrtarisht, më pas çdo kërkesë do t'i drejtohet drejtorisë kompetente për çështjet e caktuara.

Procesin e shkroi dhe përpiloj

EDONA KRASNIQI

Kryetari i Komunës

Përparim Rama

